



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

*Komisioni hetimor i Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga
Presidenti i Republikës së Shqipërisë”*

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.05.2021, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Alket Hyseni – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 8 dhe 11 maj 2021.
2. Miratimi i planit përfundimtar të hetimit.
3. Caktimi i ekspertëve ligjorë dhe përcaktimi i detyrave të tyre.
4. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Alket Hyseni, Myslim Murrizi, Klotilda Bushka, Elena Xhina, Spartak Braho, Halil Jakimi, Nikolin Staka, Xhemal Qefalia, Edmond Stojku dhe Eugen Bojaxhiu.

Mungojnë:

Vasilika Hysi dhe Arlind Çaçani

HAPET MBLEDHJA

Alket Hyseni – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e komisionit hetimor, ku janë të pranishëm të gjithë anëtarët. Sot kemi dy anëtarë zëvendësues, zotin Qefalia dhe zotin Stojku. Kuorumi i nevojshëm për ta quajtur mbledhjen të vlefshme është i mjaftueshëm. Rendi i ditës i kësaj mbledhjeje është si më poshtë:

1. Miratimi i procesverbaleve të dy mbledhjeve të kaluara të komisionit.
2. Miratimi i planit përfundimtar të hetimit.
3. Caktimi i ekspertëve ligjorë.
4. Çështje të tjera.

Jeni dakord me rendin e ditës? Ju lutem, shprehuni duke ngritur dorën.

Miratohet.

Vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës, miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 8 dhe 11 maj 2021. Procesverbalet ju janë dërguar elektronikisht, por i keni edhe në dosje. Ka ndonjë koment për procesverbalet? I hedhim në votim.

Kush është dakord me procesverbalet? Të gjithë janë dakord.

Miratohen.

Vazhdojmë me pikën dytë të rendit të ditës, miratimin e planit të hetimit. Përpara se të diskutojmë për planin e hetimit, i bëj me dije komisionit se në përgjigje të kërkesave të komisionit për informacion janë depozituar shkresat e mëposhtme:

shkresë e Shërbimit Informativ të Shtetit, e protokolluar në Kuvend me nr. 1081/18, datë 11.5.2021;

shkresë e Prokurorisë së Përgjithshme, e protokolluar në Kuvend me nr. 1081/19, datë 11.5.2021;

shkresë e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e protokolluar në Kuvend me nr. 1081/20, datë 12.5.2021;

shkresë e Autoritet të Medieve Audiovizive, e protokolluar në Kuvend me nr. 1081/21, datë 12.5.2021, e shoqëruar me 27 CD;

shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e protokolluar në zyrën e Kuvendit për Informacionin e klasifikuar sekret shtetëror me nr. 11, datë 12.5.2021.

Sapo u njoftova që ka ardhur edhe shkresa nga bashkia e Tiranës. Nëse është e mundur, kërkoj nga stafi të më jepen të dhënat për shkresën e ardhur nga bashkia e Tiranës, për t'ia bërë me dije komisionit.

Të gjitha shkresat i keni në dosje, përveç informacionit të klasifikuar sekret, që ka ardhur nga Policia e Shtetit, i cili do të vihet në dispozicion të të gjithë anëtarëve që janë të pajisur me certifikatë sigurie përkatëse, për ta parë sipas procedurës së parashikuar të materialeve sekrete. Ndërkohë, jemi në pritje të pajisjes së dy anëtarëve të komisionit me certifikatën përkatëse.

Dua të sjell në vëmendje përcaktimet e ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”. Lidhur me planin e hetimit, neni 15 i ligjit ka përcaktuar se, pasi të sigurohen të dhënat paraprake për çështjen, komisioni, me vendim të ndërmjetëm miraton planin e hetimeve deri në përfundimin e tyre.

Plani i hetimeve mund të ndryshojë gjatë zhvillimit të hetimeve kur dalin prova ose ngjarje të reja që lidhen me çështjen.

Plani i hetimit përmban të gjithë hapat proceduralë, veprimet hetimore që do të ndiqen nga komisioni për hetimin e çështjes, si dhe rrethin e personave që do të merren si dëshmitarë ose ekspertë, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale.

Pas miratimit të planit të hetimit, komisioni deklaron fillimin e hetimeve.

Plani i hetimit, i cili do të miratohet në mbledhjen e sotme, përmban të gjithë këta hapa proceduralë që do të ndiqen nga ky komision deri në përfundim të hetimit, dokumentet që do të shqyrtohen nga komisioni, si dhe afatin e zhvillimit të hetimeve dhe përfundimin e tij.

Me miratimin e këtij plani ne do të deklarojmë, pra komisioni, fillimin e hetimeve.

Kush e do fjalën lidhur me planin e hetimit?

Ju keni në dosje një plan paraprak. Ne kemi rënë pothuajse dakord edhe në takimin para mbledhjes së komisionit. Megjithatë, nëse dikush ka ndonjë gjë, ndonjë merak, mund të shprehet ose, përkundër, më lejoni për ta hedhur në votim.

Hedhim në votim planin e hetimit. Kush është dakord?

Të gjithë shprehen dakord.

Miratohet me vendim të ndërmjetëm plani i hetimit.

Urdhëroni, zoti Bojaxhiu, mund t'i bashkoheni mbledhjes.

I bëj me dije komisionit se ne kemi njoftuar që edhe anëtarët zëvendësues, pavarësisht nëse janë të pranishëm anëtarët e përhershëm të komisionit, mund, madje jo mund, por do të dëshironin të ishin pjesëmarrës në mbledhje për të ndjekur veprimet procedurale të

komisionit hetimor, rrjedhën e hetimit, në mënyrë që të jenë të mirinformuar dhe që të mos ketë nevojë për të krijuar pauza.

Kështu, bashkohet me ne edhe zoti Bojaxhiu.

Faleminderit që erdhët!

Alket Hyseni – Atëherë, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës: caktimi i ekspertëve ligjorë.

Sikurse kemi rënë dakord, së pari, ky komision ka gjykuar të nevojshme të thërrasë vetëm ekspertë ligjorë. Numri që kemi rënë dakord është dy ekspertë ligjorë.

Kush ka propozime për ekspertë ligjorë? Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Në vijim të propozimit të mëparshëm në komisionin hetimor, ku propozova zotin Erind Mërkuri për një nga ekspertët ligjorë, do të doja të mbaja po këtë propozim që një nga ekspertët ligjorë të këtij komisioni hetimor të jetë Erind Mërkuri.

Dhe përpara se të bëj një prezantim të shkurtër të tij në lidhje me gradat dhe me aktivitetin e ekspertit, do të dua të sjell në vëmendje të komisionit faktin që komisionet hetimore, sipas ligjit “Për komisionet hetimore”, kanë të drejtë të caktojnë ekspertë ose ekspertë ligjorë.

Ekspertë janë ata, të cilët vendosen, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale dhe emërohen si të tillë në këto procese për ekspertiza të ndryshme, të cilat janë të një natyre për çështje që nuk janë në njohuri të komisionit në lidhje me objektin e hetimit. Ndërsa, ekspertët ligjorë janë ata që nuk duhen ngatërruar me grupin e parë të ekspertëve, por janë ekspertë që ndihmojnë komisionin në veprimtari për çështje ligjore. Ne kemi bërë një diskutim paraprak me disa prej ekspertëve, që mund të shërbenin në këtë komision për të parë nëse kishte konflikt interesi apo jo, si dhe jemi konsultuar me kryesinë e komisionit hetimor, se kush mund t’i plotësonte kriteret për t’i shërbyer këtij komisioni, në përputhje me gjithçka që parashikon ligji, kështu që kemi arritur në konkluzionin që të kemi dy ekspertë ligjorë, njëri prej të cilëve do të jetë konstitucionalist dhe ky është zoti Erind Mërkuri.

Zoti Mërkuri ka titullin Docent dhe gradën shkencore “Doktor i Shkencave” në të Drejtën Publike. Ka mbrojtur disertacionin në “Aspektet proceduriale të gjykimi kushtetues”, dhënë nga Shkolla Doktorale e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Ka përfunduar master të nivelit të dytë në lëndën e “Drejtë kushtetuese e krahasuar dhe evropiane”, departamenti i të Drejtës Publike në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Është autor i një sërë publikimesh si libra, artikuj shkencorë, brenda dhe jashtë

vendit. Ka qenë ekspert në hartimin e disa projektligjeve dhe akteve nënligjore dhe ekspert pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për ndryshimet kushtetuese, sa i takon sistemit zgjedhor të verës 2020.

Për sa i përket eksperiencës në punë, zoti Mërkuri është konsulent vendor në Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, anëtar i Komisionit Kombëtar të përzgjedhjes për trupën e nivelit të lartë drejtues në Shërbimin Civil, lektor i lëndës “E drejta kushtetuese”, Shkolla Kombëtare e Avokatisë, ekspert trajnimi në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, avokat, pedagog i brendshëm, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranë, është ekspert i jashtëm në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ekspert i jashtëm në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Edukim, ekspert i së drejtës administrative pranë Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, ADISA, konsulent vendor Këshilli i Europës, dhe ekspert vendor në disa institucione si Sigma, Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Europian, OSBE.

Kjo është një përmbledhje e shkurtër e CV-së, por për më shumë detaje secili nga ju është pajisur edhe me curriculum vitae të zotit Mërkuri, që e dispononi besoj dhe në rrugë elektronike, por dhe në dosjet që ju janë vënë në dispozicion nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Faleminderit, zonja Bushka!

Ka ndonjë propozim tjetër?

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Atëherë, në vijim të zonjës Bushka. Duke marrë parasysh faktin që ne kemi rënë dakord të kemi dy ekspertë ligjorë, unë dua të propozoj në këtë rast, zotin Artan Spahiu.

Artan Spahiu, aktualisht mban titullin “Doktor Shkencash” të marrë në vitin 2015. Njëkohësisht, prej vitit 2010 është pedagog i brendshëm në Universitetin “Alesandër Xhuvani” të Elbasanit. Aktualisht është zëvendësdekan i Fakultetit Ekonomik. Zoti Spahiu mban titullin Avokat dhe Ndërmjetës. Është autor i disa cikle leksionesh që ndiqen nga studentët e Universitetit të Elbasanit. Është autor i disa botimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, ka marrë pjesë në disa projekte ndërkombëtare, si dhe ka përfunduar me sukses disa kurse të trajnimit profesional në fusha të ndryshme, si: prokurimi publik, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci e të tjerë. Gjithashtu, zoti Artan Spahiu ka përfunduar me sukses detyrën e tij si kryetar i Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016, që është ngritur dhe ka raportuar në Kuvend. Të gjitha këto mendoj se e bëjnë të denjë zotin Spahiu për të na dhënë ndihmë si ekspert ligjor në

komisionin tonë. Për më tepër, kolegët e kanë jetëshkrimin e tij në dosje dhe të përcjellë në rrugë elektronike. Jam në dijeni të faktit që nuk ka asnjë konflikt interesi, që e ndalon zotin Spahiu ta ushtrojë këtë detyrë.

Ftoj kolegët që ta miratojmë këtë propozim!

Faleminderit!

Alket Hyseni- Faleminderit, zonja Xhina!

Pasi të biem dakord, do të jenë vetë ekspertët ligjorë që do të thirrën këtu, të cilët do të deklarojnë a kanë apo jo konflikt interesi, por bëtë mirë që e shpjeguat.

A ka ndonjë propozim tjetër për ekspert, përveç dy ekspertëve, pavarësisht se ne kemi rënë dakord që do të jenë dy ekspertë ligjorë, nëse dikush ka ndonjë emër tjetër, mund të na e thotë. Nuk ka propozim tjetër.

Atëherë, hedhim në votim miratimin dy emrat, zotin Erind Mërkuri dhe zotin Artan Spahiu, si ekspertë ligjorë, për të cilët i keni CV-të në dosjen tuaj. Kush është dakord? Të gjithë dakord.

Atëherë, miratohet emërimi si ekspertë ligjorë i zotit Erind Mërkuri dhe i zotit Artan Spahiu.

Zoti Mërkuri të futet në sallë.

Përsëritet, zoti Mërkuri, mirë se erdhët!

Me vendim të ndërmjetëm të këtij komisioni dhe me propozim të zonjës Bushka jeni caktuar ekspert ligjor i komisionit hetimor për shkarkimin e Presidentit, me objektin e të cilit nuk e di nëse jeni njohur, por unë dua t'ju njoh specifikisht me objektin e këtij komisioni: Kuvendi, me vendim, ka ngritur komisionin për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, vendimi nr. 45 i vitit 2021. Objektivi i punës së komisionit është:

a. Hetimi dhe verifikimi nëse aktet e kryera dhe deklaratat e dhëna nga Presidenti i Republikës gjatë periudhës përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore 2021 përbëjnë shkelje të rënda të Kushtetutës.

b. Verifikimi i pasojave të këtyre akteve, në raport me parimin unitetit të popullit, prishjen e ekuilibrit politik, të qetësisë publike, nxitjen e urrejtjes dhe dhunës, vënien në rrezik të jetës së njerëzve, ndërhyrjen dhe intimidimin e institucioneve publike, dëmtimin e imazhit dhe reputacionit të vendit, si dhe marrëdhënien me partnerët strategjikë të Shqipërisë.

c. Verifikimi i akteve, sjelljeve dhe qëndrimeve të caktuara të Presidentit të Republikës në raport me rolin dhe pozitën e kushtetuese.

Ky është objekti, zoti Mërkuri.

Para se t'ju vihet në dispozicion çdo akt që ka lidhje me komisionin hetimor, do të doja të deklaronit para komisionin, së pari, nëse e pranoni detyrën e ekspertit ligjor dhe, së dyti, nëse keni ndonjë konflikt interesi apo shkak që ju bën të papërshtatshëm për këtë detyrë.

Erind Mërkuri – Faleminderit!

Po, e pranoj detyrën e caktuar për të qenë ekspert ligjor pranë këtij komisioni. Në dijeninë time, në bazë të parashikimit të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave”, nuk kam konflikt interesi në këtë çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në dijeninë time jo.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti Mërkuri! Vendimi për ju tashmë është marrë. Në bashkëpunim me ne si drejtues, unë, nënkryetari dhe zonja Bushka, si sekretare, bashkë me stafin teknik do të komunikoni për çdo material që do të keni të nevojshëm. Ju mund të qëndroni këtu për t'ju caktuar detyrat, të cilat do të bazohen në pyetje që anëtarët e këtij komisioni kanë të nevojshme për t'ju drejtuar juve.

Përpara se t'ia jap fjalën dikujt që ka propozime për detyra, dua t'ju bëj me dije se secili ka në dosje një material, të vënë në dispozicion nga Shërbimi i Kërkimit Parlamentar i Bibliotekës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili konsiston në raste të ngjashme, si: objekti i punës së komisionit, specifikisht rasti i Republikës së Lituanisë, shkarkimi i Presidentit të Republikës Rolandas Paksas, krijimi i komisionit të posaçëm hetimor për rastin, kushtetutshmëria e përfundimeve të komisionit *ad hoc*, vendimi i Gjykatës Kushtetuese 30 dhjetor 2003 në lidhje me kushtetutshmërinë e dekretit presidencial që i jep shtetësinë lituaneze zotit Juri Borisov, komisioni i posaçëm parlamentar për *impeachment*, fajësimi i Presidentit në parlament, fazat e ndryshme, vendimi i Gjykatës Kushtetuese lituaneze i datës 31 mars 2004 për shkarkimin e Presidentit të Republikës Rolandas Paksas dhe vendimi i Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut në çështjen Paksas kundër Lituanisë, së bashku me referencat përkatëse. Është një material që unë do të dëshiroja që secili ta lexojë me vëmendje, sepse do të jetë shumë i frytshëm për punën tonë.

Natyrisht që këto materiale mund t'i vihen në dispozicion edhe ekspertit, por eksperti do të ketë një gamë më të gjerë të hulumtimit për ta vënë në dispozicion.

Përveç pyetjeve, unë do të dëshiroja që, sa të jetë e mundur, të na vihen në dispozicion qëndrimet e jurisprudencës së Gjykatës sonë Kushtetuese, të qëndrimeve të Komisionit të Venecias për çështje të ngjashme apo me qëndrime të caktuara të mëparshme në kërkesat që ka drejtuar Republika e Shqipërisë, qëndrime të gjykatave kushtetuese të

vendeve të tjera për raste të ngjashme, përveç rastit të Lituanisë, qëndrime të fushës të Gjykatës Europiane, nëse ka (sikurse konstatohet nga ky material, së paku, një rast është), por unë do të dëshiroja edhe kasio të ngjashme në parlamente të tjera lidhur me impiçmentin duke marrë spunto, për shembull, nga rasti më i freskët, procedura e nisur, pavarësisht e papërfunduar, në kongresin amerikan për Persidentin Tramp.

Kush ka pyetje për ekspertin?

Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka – Faleminderit, kryetar!

Nisur paraprakisht nga ajo për të cilën kemi rënë dakord, që kemi caktuar ekspertë ligjorë, të cilët do ta ndihmojnë këtë komision me doktrinë kushtetuese dhe ligjore, ne kemi diskutuar një seri pyetjesh, të cilat paraprakisht unë do t'i prezantoj dhe, në një farë mënyre, do të jenë edhe detyrat e ekspertit, por sigisht nuk është ezauruese kjo që unë do të prezantoj. Të gjithë kolegët e tjerë të komisionit janë të lirë t'i shtojnë pyetje apo kërkesa detyrës së ekspertëve në vijim të asaj që do të paraqes unë.

Vetëm një gjë duhet mbajtur në konsideratë, që kolegët tanë deputetë, në bazë të të cilëve është nisur kjo procedurë për shkarkimin e Presidentit të Republikës, bazuar në Kushtetutë, u janë referuar shkeljeve të Kushtetutës të parashikuara në nenin 86, 89 dhe 94 të Kushtetutës.

Ky do të jetë në një farë mënyrë edhe fokusi i punës sonë, pra objekti i hetimit është në lidhje me këto shkelje.

Duke pasur parasysh që ne si komision nuk kemi të gjitha njohuritë juridike, të gjithë njohuritë e doktrinës kushtetuese mbi këto dispozita, edhe puna e ekspertëve do të jetë që të ndihmojë këtë komision për interpretime në bazë të praktikës së Gjykatës Kushtetuese,, standardeve më të mira ndërkombëtare, siç e përmendi edhe zoti Hyseni, opinioneve të Komisionit të Venecias apo raste të ngjashme në vende të tjera, të cilat japin sa më shumë informacion mbi standardet dhe mbi të drejtën.

Unë po paraqes pyetjet e para, që ne gjujkojmë se duhet të kemi një përgjigje nga ekspertët ligjorë dhe më pas çdo koleg, sigurisht, nuk mund të fokusohet vetëm te pyetjet e mia, çdokush ka të drejtë të paraqesë edhe pyetje të tjera, por duke iu përmbajtur këtyre parimeve.

Do t'i paraqesim edhe me shkrim, zoti Mërkuri, por, për efekt edhe të regjistrimit të mbledhjes, por edhe për transparencë publike, pyetjet që çmoj se ju duhet të punoni për përgjigjet janë:

Cili është roli i Presidentit në një republikë parlamentare, siç është Shqipëria? Cilat janë kompetencat e Presidentit, sipas Kushtetutës? Cila është mënyra e ushtrimit të këtyre kompetencave? Çfarë nënkuptohet me shprehjen “President, si përfaqësues i unitetit të popullit” në nenin 86 të Kushtetutës? Cili është interpretimi i termit “interes i përgjithshëm” në Kushtetutë?

Ky komision do të çmonte shumë një analizë të nenit 89 të Kushtetutës për ndalimet që parashikon Kushtetuta jonë në lidhje me aktivitetin e Presidentit.

Cilat janë, sipas praktikës së Gjykatës sonë Kushtetuese, raste të ngjashme që japin standarde ndërkombëtare, sipas praktikës së Komisionit të Venecias e të tjera të ngjashme me këto, ato kritere të cilat vlerësojnë rëndësinë e një shkeljeje kushtetuese referuar, siç ju thashë më parë, të gjitha atyre burimeve të së drejtës që përmenda?

Një pyetje tjetër: cilat janë përgjegjësitë e Presidentit të Republikës në kuadër të marrëdhënieve me jashtë të shtetit shqiptar?

Këto janë pak a shumë pyetjet që, paraprakisht, i kemi diskutuar dhe kemi rënë dakord që ky komision kërkon të ketë disa analiza, por, nga ana tjetër, na duhet të kemi edhe një përmbledhje të rasteve të ngjashme në praktikë në Europë apo më gjerë për çështje të natyrave të njëjta. Pak a shumë, një material, siç e tha zoti Hyseni, ne e kemi tashmë nga Shërbimi i Kërkimit të Kuvendit, por çdo hulumtim i mëtejshëm, çdo kërkim, i cili i shërben objektit dhe veprimtarisë së këtij komisioni, është më se i rëndësishëm.

Të nderuar kolegë, këto janë pyetjet që kisha përgatitur në konsultim pothuajse me të gjithë ju për t’i paraqitur që do të na ndihmonin në punën tonë si komision hetimor, megjithatë jam e hapur nëse ju keni ende pyetje, për të cilat është e nevojshme të kemi përgjigje nga ekspertët ligjorë.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Faleminderit, zonja Bushka!

A ka dikush ndonjë koment rreth pyetjeve, apo ndonjë propozim tjetër. Por përpara se t’u jap fjalën kolegëve, do të doja edhe një herë t’i kujtoja kolegët që, për shkak të delikatesës dhe rëndësisë që ka procedura në këtë komision hetimor, do t’ju ftoja që pyetjet të mos jenë sugjestionuese, të mos jenë paragjykuese, të kemi kohë për të krijuar bindjen e secilit anëtar dhe pastaj, përtej bindjes së secilit, qëndrimin këtij komisioni, pasi të marrim provat e duhura nga të gjitha institucionet, pasi të dëgjojmë edhe Presidentin e Republikës, nëse ai do që të dëgjohet, apo nëse do të thërrasim të tjerë për t’u dëgjuar, pasi të dëgjojmë qëndrimin e ekspertëve, ne do të kemi formuar bindjen tonë, dhe është e drejtë e gjithsecilit patjetër të japë qëndrimin nëse jemi në rrethanat që ngrihen në kërkesën e 49 deputetëve apo

jo. Përtej kësaj, pas mbarimit të procedurës në Komisionin e Ligjeve dhe në seancën plenare, me daljen me vendim të Kuvendit, ky komision na ka bërë ne më pak politikë. Me këtë unë nuk po them se jemi të përjashtuar politikisht, por tashmë jemi në kuadrin e një *quasi* tribunali, *quasi* gjykate dhe duhet të jemi shumë të kujdesshëm për të mos e paragjykuar qëndrimin tonë, qëndrimin e këtij komisioni hetimor. Më falni që e ripërsërita këtë qëndrim, por më takonte ta bëja.

Urdhëroni, zoti Murrizi, kishit diçka për të shtuar!

Myslim Murrizi – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, kam një kërkesë dhe ndoshta një sugjerim për administratën e Kuvendit. Nisur nga çka ju thatë tani në fund, për dijeni të publikut, unë të paktën besoj se të gjithë ne do të jemi deputetë deri në datën 9 shtator, pavarësisht se i pëlqejmë apo jo cilitdo funksionari apo jo funksionari të këtij shteti, respekti individual është reciprok. Nëse nuk më respekton në mënyrë individuale, mua nuk ma ndjen fare, por në mënyrë kushtetuese jam i detyruar që edhe atë që nuk e kam qejf në mënyrë individuale ta respektoj për karrigen, statusin dhe pozicionin juridik e shoqëror që ka gjithsecili. Ne nuk bëjmë gjyqe, se ti the se jemi gjykatë, por do të shprehemi me votë. Unë këtu jam shumë rehat dhe i qetë me veten, besoj se edhe të gjithë kolegët e tjerë, ndaj dua të them se është hera e parë që një komision hetimor ka edhe një organ tjetër që do të gjykojë vendimin tonë. Pra, ne do të kalojmë në dy filtra: së pari, vendimi i këtij komisioni do t'i nënshtrohet një votimi në seancë, pra më shumë se 9 kolegë që jemi këtu së bashku, dhe, së dyti, vendimi i Kuvendit me çfarëdo numrash, nëse do të jetë me 94 vota në favor të raportit, nëse raporti do të jetë për shkarkimin e Presidentit, do t'i kalojë Gjykatës Kushtetuese. Pra, nuk është se jemi ne ata që do të vendosim litarin dhe do të heqim stolin që duhet të rrimë kaq hermetikë, sa kushedi se çfarë po bëjmë.

Unë i dëgjova rastet që ju cituat më parë dhe do të doja që shtrinim pak kërkesën në arshivat e parlamentit, jo vetëm tek ish-vendet komuniste, siç ju morët si shembull Lituaninë. Ne gjithmonë kemi dashur të marrim si model vendet këtej (herën tjetër ia kam kërkuar sekretares së komisionit, gjë të cilën nuk e shikoj të më ketë ardhur), ndaj në mbledhjen e tjetër do të doja të kishin në dispozicion praktikën e shkarkimit të Presidentit të Italisë, *Craxi*, në vitin 1993. Ai është anëtar i G8-ës, G20-ës, themelues i BE-së, ndaj unë do të doja t'i merrnim si model italianët, përveç Lituanisë. Po them se dy - tre komisionet e fundi, që janë ngritur në Senat apo në Kongres Amerikan për Presidentin Trump. Pra, të na vihen në dispozicion praktika parlamentare, me kërkesë të një deputeti, që është bërë në vitin '93, për atë akuzë që ka pas, se çfarë hapash ka ndjekur Republika Parlamentare Italiane për

shkarkimin e Presidentit të tyre, që ta kemi si model. Unë nuk mjaftohem me Lituaninë, Kirgistanin apo Uzbekistanin, pra me ish-kooperativat bujqësore.

Duke parë përgjigjet, pa dashur t'u jap zë se çfarë kanë thënë institucionet, ndoshta do të ishte e nevojshme, përpara se të themi nëse do të vijë apo jo Presidenti, sepse nuk e detyrojmë, ne nuk jemi prokurori speciale, por komision hetimor, pra nuk shoqërojmë njeri me forcë për të ardhur këtu, do të doja që të kishim të pranishëm në një seancë dëgjimore, ndoshta me dyer të mbyllura, siç e thotë Rregullorja, shefin e Shërbimit Informativ, ndoshta edhe drejtorin e Policisë së Shtetit. Pra, përveç përgjigjes së thatë, me shkrim, nëse shihet e arsyeshme, të bëjmë disa pyetje konkrete, që të mos bëjmë lojën e kungulleshave. Unë, si deputet dhe si anëtar i këtij komisioni, kam të drejtën time t'ua nis me shkrim pyetjet, pra t'i formuloj dhe në emër të komisionit t'u nisen pyetje konkrete, por nuk do të ishte keq që të gjithë deputetët që janë me certifikatë sigurie, të ishin në një seancë dëgjimore me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe me shefin e Shërbimit Informativ për detaje dhe teknikalitete, për të cilat unë, por edhe kolegët e tjerë mund të kenë informacione konkrete.

Unë i lexoj shkresat e tyre, të cilat janë formale. Ne nuk i kemi thënë Shërbimit Informativ që duhet të ndjekë as Presidenti dhe as Kryeministrin, sepse nuk e kanë si detyrë kushtetuese, por ne do t'i pyesim për disa detaje në një ambient komform Rregullores dhe asaj që përcakton sekretin shtetëror nuk ka asgjë të keqe, mendoj unë.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti Murrizi!

Pra ju ngritët dy çështje: kërkesën për ekspertin për sa u takon praktikave të ngjashme në vendet perëndimore, duke përmendur rastin “Craxi”, që patjetër eksperti i ka mbajtur shënim.

Së dyti, kërkesën për të dëgjuar drejtorin e Përgjithshëm të Policisë dhe drejtorin e Shërbimit Informativ.

Për sa i takon çështjes së parë, mendoj që nuk përbën ndonjë problem dhe them që është brenda kërkesës normale të një anëtari. Ju bëj me dije se iu referuam Lituanisë, sepse ka një rast totalisht të ngjashëm dhe të përfunduar, por kjo nuk do të thotë që nuk do t'u referohemi kauzave të tjera. Për më tepër, Lituania është një vend demokratik, me një nivel të lartë të institucioneve demokratike, pavarësisht historikut të saj si vend ish-komunist apo si republikë e ish-Bashkimit Sovjetik, sot është shembull i demokracive perëndimore, ku funksionon parimi i shtetit të së drejtës në mënyrë perfekte. Megjithatë, eksperti e mbajti shënim.

Për sa i përket çështjes së dytë, unë mendoj që të mos nxitohemi. Ne u jemi drejtuar me shkresa. Nëse keni ndonjë situatë mund t'i ridrejtojmë shkresat, sepse edhe seanca dëgjimore do ta bënte sërish joefektive, pra kur nuk ka në dispozicion kërkesat tona, sepse asnjë drejtues nuk mund t'i dijë të gjitha gjërat pa pasur informacion.

Unë do t'i ftoj anëtarët që, për çdo shqetësim apo nevojë për informacione me këto institucione, të na bëhet me dije dhe ne t'ua nisim shkresën. Besoj se do të marrim përgjigje.

Në fund të këtyre përgjigjeve, nëse anëtari do të ketë rezerva, që informacioni është i paplotë, i pasaktë apo në mungesë, mund të shikojmë qëndrimin.

Do t'ju lutesha që çdo kërkesë që mund të keni, bazuar edhe në të drejtën që ju jep ligji "Për komisionet hetimore", t'ua adresoni me shkresë institucioneve dhe më vonë të shikojmë për këtë qëndrim.

Jeni dakord?

Kështu e kemi lënë edhe në planin hetimor.

Jeni dakord për këtë qëndrim për sa u përket kërkesave të zotit Murrizi?

Miratohet.

A ka shqetësime të tjera nga kolegët?

Po, zoti Braho!

Spartak Braho – Duke studiuar materialet që kemi në dispozicion, kam një çështje, e cila, në tërësinë e saj kërkon njohuri speciale, por jo të fushës së ekspertimit ligjor.

Duke përfituar nga fakti që kemi anëtarë komisioni dy mjekë të dëgjuar, doktor Edmond Stojkun dhe Eugen Bojaxhiun, dua ta vë në dukje këtë gjë.

Në sensin e problematikës që unë shikoj nga leximi i materialeve, por jo të paragjykimit, kam thjesht merakun sqarues, pra çështja është: në materialet audio dhe vizive, që disponon ky komision për deklaratimet e Presidentit, në data të ndryshme të periudhës zgjedhore, të krijohet përshtypja se ai shfaqet në gjendje psikologjike dhe karakteriale aspak normale, madje ka formuluar edhe akuza për persona të veçantë, drejtues kryesorë të shtetit, të cilët trajtojnë dhe shfaqen si kapërcime logjike të tijat. Kështu i vlerësoj unë.

Në datën 24 prill, Presidenti deklaroi publikisht: "Të dashur prokurorë dhe gjyqtarë, dëgjojeni mirë Presidentin e Republikës! Boll dëgjuat përfaqësuesit e Ndranghetës, Don Agaçion! Nëse jo, një pikë gjak të derdhet nesër, por edhe një pikë lot, mjerë ju! Nesër duhet të jetë festa e demokracisë".

Sërish në datën 24 prill, ditën e heshtjes zgjedhore Presidenti deklaroi: "Kriminelët janë kudo të rrezikshëm, por me të rrezikshëm janë kriminelët e veshur me uniformë, janë ata që gjenden brenda sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë, prandaj thirrini mendjes!", etj.

Përsëri në datën 24 prill: “Sfurqet do të jenë të dielën nëse preket vota, zgjedhje si të Shijakut dhe të Dibrës nuk do të ketë më. Kjo histori ka marrë fund, unë kam besim të shqiptarët”, etj. Në datën 20 prill: “Babëlok, shqiptarët e dinë shumë mirë se kush është kurdisës dhe përçarës i shqiptarëve në Shqipëri dhe në rajon. Me qetësi dhe me vendosmëri do të marrësh përgjigjen më 25 prill nga të gjithë shqiptarët patriotë europianë dhe në radhë të parë nga socialistët, që shkatërrojnë çdo vlerë pozitive dhe njerëzore. Unë do të shkoj në shtëpi dhe ti do të shkosh në psikiatri”, etj. Edhe një tjetër: “Detyra e qytetarit është të votojë. Unë u them qytetarëve: kush ju ka bërë presion në vendin e punës, kush ju ka blerë votën, ndëshkoheni më votë!. Unë nuk kam asnjë interes, as se çfarë ka thënë dhe as se çfarë thotë njëri apo tjetri. Me 26 prill ma ndërroni emrin dhe vendoseni si të doni! Nëse një votë vidhet do t’i pritet dora në sheshin Skënderbej””, etj, nuk po zgjatem.

Alket Hyesni – Janë në planin e hetimit këto.

Spartak Braho – Të nderuar kolegë deputetë, për fat edhe mjekë, këto janë çështje shumë specifike për t’i vlerësuar ne si juristë, prandaj unë shtroj pyetjen: si e vlerësoni ju si specialistë të mjekësisë gjendjen psikike të Presidentit? Mos jemi në kushtet e papërgjegjshmërisë së tij?

Alket Hyesni – Më fal, zoti Braho, kujt ia drejtuat?

Spartak Braho – Zotit Edmond Stojku dhe Eugent Bojaxhiut

Edmond Stojku – Normalisht në materialin e lexuar...

Alket Hyesni – Një minutë, do t’jua jap të drejtën meqë t’u drejtua zoti Braho, por do të kërkoja mirëkuptimin që pavarësisht se është një nga rastet që parashikohet në Kushtetutë, por procedurat, për të cilat ne jemi vënë në lëvizje nga kërkesa e 49 deputetëve, nuk është rasti konkret, megjithatë për merakun që ka zoti Braho mund të jepni një përgjigje për aq sa ju mund të keni njohuri të kufizuara, por paralajmëroj që nuk është objekti i veprimtarisë së këtij komisioni.

Sa për një sqarim, meqenëse shqetësimi u ngrit, mund të flisni.

Edmond Stojku – Dakord.

Faleminderit, kryetar!

Pikërisht këtë desha të shtoj. Desha të theksoj se ky është një problem krejt profesional, mjekësor, dhe historia na tregon që në daljet publike të individëve të pushtetshëm ka pasur prononcime të gabuara, të cilat kanë qenë gafat më të mëdha në histori dhe kush ka informacion e di që këto kanë ndodhur në të gjithë botën demokratike e më gjerë.

Problemi është që këtu diskutohet për një labilitet emocional, për një luhatje të theksuar të humorit, që në gjendjet e stresit varion me shpërthime, të cilat, në fakt, arrijnë të

keqpërdorin momentin dhe të arrijnë në vendimmarrje të gabuara të individëve me pushtet. Kjo vjen nga moskontrolli i emocionave dhe manifeston pikërisht këto sjellje shpërthyes.

Mendoj se nuk do të ishte keq, nëse mendohet si pozitive nga komisioni dhe nëse është në objektin e komisionit, një këqyrje më e thellë profesionale, që mund të nxjerrë konkluzione më të detajuara specifike. Nuk e di nëse do të ishte e udhës të merrej në konsideratë, por këto gjendje njihen jo vetëm te njerëzit e pushtetshëm, por edhe te njerëzit e zakonshëm. Pra, stresi emocional, labiliteti emocional, luhatjet e caktuara, gjendjet e caktuara të këtij lloji ndodhin dhe, në fakt, nuk duhet të ndodhin në vazhdimësi, nuk duhet të ndodhin për një periudhë të gjatë kohe, sepse rimarrja në kontroll e vetes, e individit, sidomos për njerëzit e padiagnostifikuar, është më se e normës, por në këtë rast, kur kemi disa shpërthime të herëpashershme për një kohë të gjatë të caktuar, mendoj se mund të jetë një objekt që mund të merret në konsideratë. Megjithatë, komisioni e di më mirë dhe le të vendosë vetë.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti Stojku!

Zonja Bushka.

Klotilda Bushka- Është e drejtë e çdo anëtari të komisionit që, për t'i shërbyer procedurës së hetimit, siç dhe e ka për detyrë ky komision, të paraqesë kërkesa që i çmon të nevojshme, por duhet të kemi në konsideratë që ky komision vepron në bazë të vendimit të Kuvendit, i cili ka përcaktuar qartë edhe objektin e punës së tij, dhe në objektin e punës bazë është kërkesa e 49 kolegëve tanë deputetë për shkarkimin e Presidentit për shkelje të rënda të Kushtetutës dhe, konkretisht, siç e thashë edhe më parë, të neneve 86, 89 dhe 94.

Neni 86 bën fjalë për rolin e Presidentit si kryetar shteti, që përfaqëson unitetin e popullit.

Neni 89 parashikon shprehimisht se Presidenti i Republikës nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private. Pra, po i referohem kërkesës së 49 deputetëve.

Në nenin 94 thuhet shprehimisht se Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera, përveç atyre që i njihen shprehimisht në Kushtetutë dhe që jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të. Po ta analizojmë bazën ligjore, shkaqet për të cilat ky komision vepron, në bazë të vendimit të Kuvendit, i cili është nxjerrë në sajë të një kërkesë të 49 kolegëve deputetë, jemi para rastit që ky komision hetimor duhet të hetojë nëse vërtetohen shkeljet dhe nëse janë të tilla, që justifikojnë shkarkimin e Presidentit. Në kërkesë, prandaj them se ne e kemi objektin e punës të përcaktuar tashmë, nuk referohen ato që kanë të bëjnë me çështjet që ngriti zoti Braho, që kanë të bëjnë me pamundësinë e ushtrimit të detyrës, qoftë edhe për mosekulibër fizik dhe emocional e të tjera, siç e thotë edhe zoti Stojku.

Prandaj, është një procedurë tjetër ajo, që parashikohet në nenin 91 të Kushtetutës. Ndërkohë, ne, në bazën ligjore, në objekt pune të këtij komisioni kemi, pikërisht, verifikimin e hetimit të shkeljeve, që pretendohen nga kolegët deputetë dhe nëse janë të tilla, që do të përlligjin shkarkimin.

Kështu që, unë nuk paragjykoj kërkesat e kolegëve, ndoshta, nëse i hyjmë me detaje, të gjithë kemi mendimet tona të ndryshme në lidhje me situatat e krijuara, por që ky është shtrati mbi të cilin ne duhet të veprojmë.

Alket Hyseni - Faleminderit!

Urdhëroni!

Spartak Braho - Është plotësisht procedurale, e bazuar që ne veprojmë mbi bazën e planit të hetimit që kemi miratuar, por në thelb të materialit, që ne analizojmë, pra të këtyre shkeljeve që do të vëmë në dukje, është brenda logjikës që duhet të hetojmë edhe shkaqet.

Nuk e di, këto janë veprime të një njeriu të çmendur, se populli ashtu e quan atë, apo janë veprime të një njeriu, që është mbërthyer nga emocionet dhe kapërcen në raste, të cilat zoti Stojku i paraqiti? Pra, ne nuk duhet të shmangemi nga analiza e shkaqeve që e kanë çuar Presidentin në ato veprime, nëse ato janë në shkelje të rënda të Kushtetutës.

Alket Hyseni – E vlerësoj sqarimin tuaj zoti Braho, por, duke qenë i bindur në mirëkuptimin tuaj, meqenëse është jashtë objektit, nuk po e hedhim as në votim, sepse, së pari, e sqaroi zonja Bushka, që kërkesat e anëtarëve administrohen pa u hedhur në votim kur janë brenda objektit të veprimtarisë së këtij komisioni.

Për më tej, zoti Braho, ju keni një eksperiencë në të kaluarën, që keni pasur prova shumë të forta për presidentët lidhur me këtë aspekt dhe nuk është çuar deri në fund. Kjo ishte për t'ju ngacmuar.

Atëherë, a kemi ndonjë kërkesë tjetër nga eksperti që kemi këtu, në mënyrë që eksperti të bëjë një deklaratë që stafi teknik këmbëngul që një deklaratë që merr përsipër punën, të saktë, sipas tekstit të përcaktuar. Janë mbajtur shënime të gjitha detyrat për t'u dhënë një përgjigje. Kuptohet që ekspertët do të punojnë së bashku, edhe veç e veç, detyrat janë automatikisht për të dy, por eksperti tjetër do të paraqitet dhe do të deklarojë nëse e pranon dhe nëse ka konflikt interesi në mbledhjen tjetër të komisionit dhe të vazhdojë punën.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Doja të bëja një ndërhyrje për procedurë.

Do të sugjeroja që, nëse kolegët e komisionit do të kishin pyetje për ekspertët, t'i përgatisin me shkrim dhe të hënën, kur të kemi seancën e radhës, t'ua vini në dispozicion, se ndoshta deri të hënën mund t'ju dalin pyetje lidhur me objektin e hetimit.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Për shkak të rrethanave apo dëshmimeve të reja që mund të paraqiten, secili nga ne mund të ketë pyetje të tjera për t'ia paraqitur ekspertit, por sot këto janë pyetjet.

Biem dakord që eksperti të fillojë punën?

Zoti Mërkuri, mund të deklaroni nëse i morët pyetjet dhe deklaratën për ushtrimin e detyrës?

Erind Mërkuri – I nderuar kryetar i komisionit,

Mora shënime lidhur me pyetjet, megjithëse, siç mu komunikua, do të më jepen edhe në formë të shkruar nga ana e komisionit.

Mbi këtë bazë, i vetëdijshëm për përgjegjësinë morale dhe juridike për detyrën që marr përsipër, deklaroj se do ta realizoj atë me paanshmëri dhe objektivitet, bazuar në njohuritë e së drejtës kushtetuese, doktrinës kushtetuese, si dhe të jurisprudencës të Gjykatës Kushtetuese shqiptare dhe atyre të huaja.

Alket Hyseni – Faleminderit!

Do të na duhet të caktojmë edhe një afat, duke qenë se edhe afati i veprimtarisë së këtij komisioni është i kufizuar. Besoj se, sipas kalendarit që kemi miratuar, javën që vjen ne kemi mbledhje edhe ditën e hënë, edhe të martën, ku kemi rezervuar seancën dëgjimore me Presidentin e Republikës.

Është e mundur që materiali juaj, në përgjigje të pyetjeve, të jetë gati ditën e mërkurë, javën që vjen, në datën 19, por para ditës së premtë, ku ne duhet të përmbledhim të gjithë materialin hetimor?

Erind Mërkuri – Do të përpiqem që brenda afatit, maksimalisht brenda datës 20 paradite, ta dorëzoj materialin.

Alket Hyseni – Atëherë, le të caktojmë datën 20 si afat për dorëzimin e materialit me shkrim nga ana e ekspertit dhe nëse do të jetë e nevojshme edhe në seancë për të dhënë sqarime apo edhe ndoshta ndonjë pyetje tjetër të kolegëve.

Ju lutem, sekretaria të zbardhë pyetjet për ekspertin, në mënyrë që të jenë të formuluar sipas propozimeve që u bënë nga komisioni, dhe t'i vihen në dispozicion.

E ezauruam rendin e ditës dhe nëse dikush nuk ka gjë për të shtuar, atëherë mbledhjen e komisionit e deklaroj të mbyllur.

Ditë të mbarë dhe punë të mbarë të gjithë anëtarëve të komisionit dhe ekspertëve!

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA